



Kalendari i aktiviteteve për Javën e Parasë

27 –31 mars 2017

Java e Parasë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara. Gjatë javës, partnerë të shumtë në mbarë globin, nën koordinimin e Child and Youth Finance International (CYFI) dhe të Federatës Europiane të Bankave (EBF), organizojnë aktivitete të larmishme për t'i përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, duke u mësuar si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht apo si t'i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike ku jetojnë, si të fitojnë të ardhura nëpërmjet sipërmarrjes dhe të vendosin bazat për të ardhmen e tyre nëpërmjet kulturës financiare.

Organizatorë:

Banka e Shqipërisë (BSH) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e:

Ministrit të Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), Junior Achievement (JA), Shërbimit Kombëtar për Rininë (SHKR)

E hënë, 27 mars 2017

11:30 - 11:50 **Ceremonia e çeljes së Javës.** Të pranishëm: Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ministri i Arsimit dhe Sportit, si dhe Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Të pranishmit do të mbajnë nga një fjalë të shkurtër për të ndërgjegjësuar publikun mbi misionin e Javës Globale të Parasë dhe rëndësinë e kursimit.

Vendi: Muzeu i Bankës së Shqipërisë

11:50 - 12:30 Pas fjalëve përshëndetëse nga përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse, do të ndahen çmimet për fituesit e tre konkurseve, të organizuara *online*, në faqen edukative Facebook të Bankës së Shqipërisë.

1. Konkursi me vizatime “Paraja ime”. Nxënësit e shkollave fillore (klasat I-III) ftohen të realizojnë vizatime të thjeshta mbi konceptin e tyre të parasë dhe të kursimit. Vizatimet do të postohen në faqen tonë Facebook dhe 10 vizatimet që do të marrin më shumë “pëlqime”, do të fitojnë dhurata simbolike dhe mund të ekspozohen në ambientet e Muzeut të Bankës së Shqipërisë.



Çmimet për 10 vizatimet më të pëlqyera:

- 5 vizatimet e renditura të parat - 10.000 lekë
- 5 vizatimet e renditura në vijim – 5.000 lekë

2. **Konkursi “Videoja më e mirë”** – Të gjithë nxënësit e shkollave të mesme janë ftuar të konkurrojnë me videot e krijuara prej tyre. Tema që duhet të trajtojnë është **“Kurse për ditë të vështira! Kurse për ditë më të mira!”**. Videoja mund të jetë produkt individual apo i punës në grup, nuk duhet të jetë më e gjatë se 2 minuta, dhe duhet të dërgohet pranë Bankës së Shqipërisë, brenda datës 17 mars. Fituese do të shpallen 3 videot që do të pëlqehen më shumë në rrjetin social Facebook.

Çmimet për 3 videot më të pëlqyera:

- Vendi i parë – 50.000 lekë
- Vendi i dytë – 30.000 lekë
- Vendi i tretë – 20.000 lekë

3. **Konkursi “Eseja më e mirë”** me temë **“A duhet të jetë i detyrueshëm edukimi financiar në kurrikulën akademike?”**. Në këtë konkurs, ftohen të marrin pjesë studentë të degës financë-bankë të vitit të tretë, duke dorëzuar brenda datës 17 mars, esenë e tyre argumentuese, në formë elektronike (pdf), në gjuhën shqipe, jo më të gjatë se 1500 fjalë.

Çmimet për 3 esetë më të mira:

- 3 tablet
- Praktika mësimore 3-mujore

E martë, 28 mars 2017

11:00 - 13:00

Konkursi me studentët e Universiteteve “Sikur të ishim bankierë?”; AAB në bashkëpunim me Departamentin e Financës të Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve do të zhvillojnë këtë aktivitet me studentët më të mirë të Degës Financë-Bankë. Ato paraqesin para Jurisë zgjidhjen financiare për rastin studimor që iu është dhënë paraprakisht! (rasti bazohet në njohuritë që ata kanë marrë). Juria do të vlerësojë skuadrën që do të paraqitet më denjësisht. Universitetet: TBU, Luarasi, Universiteti i Tiranës



E mërkurë, 29 mars 2017

- 9:00 - 11:30 **Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe orë mësimore për nxënës të shkollave fillore me temë “Mëso. Kurse. Fito.”– (BSH)**
- 10:00 - 12:00 **Leksione¹ nga drejtorë të bankave tregtare dhe përfaqësues të BSH-së për studentë të degës financë-bankë, në universitete dhe/apo qendra rinore (BSH, AAB, ASD)**
- 90:00 – 12:00 **Shfaqje teatrale “Biçikleta e Kuqe” në Teatrin Eksperimental “Spahi Vogli” për fëmijët e klasave të treta.** Shfaqja parashikon skenografi të dedikuar, 5 aktorë si dhe lojëra ne grup.
Pjesëmarrje e 500 fëmijëve të shkollave fillore.
- 17:00 – 18:00 **Ekspozitë me temë “Edukimi Financiar përmes Artit”.** Mbi 30 fëmijë të shkollave 9-vjeçare (nga Tirana dhe Durrësi) do të bëjnë piktura për të shpjeguar disa koncepte ekonomike, nën kujdesin e piktorit **Kosta Zhongo**. Këto piktura do të bëhen pjesë e një fjalorthi ekonomik për fëmijë (vizatime + shpjegim i konceptit ekonomik).
Vendi: Galeria Fab, Universiteti i Arteve, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

E enjte, 30 mars 2017

- 10:00 - 11:30 **Kampi i Inovacionit**
- Junior Achievement of Albania, me mbështetjen e Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Bankës së Shqipërisë do të organizojnë Kampin e Inovacionit. Në këtë kamp do të marrin pjesë nxënës të klasave të 11-ta të rritit JA nga Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Kruja. Ata do të grupohen në ekipe prej 6 vetash për të parashtruar zgjidhje inovative, për sfidën: **“Si t’i mundësojmë biznesit (bankave) rritjen e klientelës, duke përmirësuar teknikat e marketingut nëpërmjet përdorimit të teknologjisë mobile”**. Në zgjidhjen e kësaj sfide, ekipet do të asistohen nga përfaqësuesit e disa bankave tregtare.

¹ Leksionet do të shpërndahen në ditë të ndryshme të Javës, sipas axhendave të lektorëve dhe universiteteve.



- 12:00 – 15:00 **Shfaqje teatrale “Bicikleta e Kuqe” në Teatrin Eksperimental “Spahi Vogli” për fëmijët e klasave të treta.** Shfaqja parashikon skenografi të dedikuar, 5 aktorë si dhe lojëra ne grup.
Pjesëmarrje e 500 fëmijëve të shkollave fillore.
- 17:30 – 18:30 **Leksion i hapur i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko,** me studentët dhe pedagogët e Universitetit European të Tiranës, me temë: **“Roli i Bankës së Shqipërisë në ekonomi. Ndërthurja midis nxitësit dhe rregullatorit”.**

E premte, 31 mars 2017

- 9:00 - 11:30 **Vizita të nxënësve të shkollave të mesme në degët e bankave dhe aktivitet edukativ** (prezantim dhe shpërndarje materialesh edukative)²
- 14:00 – 16:00 Organizimi i një **konkursi midis nxënësve të 3 shkollave të mesme** që kanë zgjedhur tekstin lëndor **“Financat Personale në Duart Tuaja”**: shkolla “Besnik Sykja”, Tiranë, shkolla “Qemal Stafa”, Tiranë, dhe shkolla “Raqi Qirinxhi”, Korçë. Konkursi do të organizohet në studion televizive të OraNews, në datën 31 mars, do të moderohet nga një gazetar ekonomik dhe më pas do të transmetohet në televizion. Juria e konkursit do të përbëhet nga drejtues të Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave.

² Vizitat mund te ndahen ne ditë të ndryshme në varësi të disponibilitetit të bankave dhe shkollave